



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:060623  
Datë: 04.04.2024  
Numri i dokumentit: 05543367

Ac.nr.1763/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët : Besnik Bislimaj - kryetar, Naim Mehulli dhe Besnik Feka, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit E. S. nga fshati Torinë, komuna Lipjan, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson I. G. avokat nga Prishtina, kundër të paditurës R. T. SH.P.K. njësia “RT PETROL” me seli në Çagllavicë, për shkak të kthimit në punë dhe kompensimit e kontributeve personale, duke vendosur sipas ankesës së paditësit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Dega në Graçanicë, C.nr.63/2020 datë 12.12.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 04.04.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

APROVOHET e themeltë ankesa e paditësit E. S. nga fshati T., komuna Lipjan, PRISHET aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Dega në Graçanicë, C.nr.63/2020 datë 12.12.2022 dhe lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin e ankimuar C.nr.63/2020 datë 12.12.2022, ka vendosur: HUDHET padia e paditësit E. S. nga fshati T., Komuna Lipjan të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Ilir Gashi avokat nga Prishtina, kundër të paditurës R. T. SH.P.K. njësia RT PETROL Çagllavicë, komuna Graçanicë, për shkak të kthimit në punë dhe kompensimit të pagave të papaguara me kontribute, si JO NË KOHË.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë paditësi, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe aplikim të gabuar të së drejtës materiale, me propozim Gjykatës së Apelit në Prishtinë që të aprovoj ankesën e paditësit si të e bazuar dhe të prishet aktvendimi i ankimuar dhe lënda ti kthehet të njëjtës Gjykatë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Përgjigje në ankesën e paditësit ka parashtruar e paditura me propozim gjykatës së Apelit që ankesën e paditësit ta refuzojë në tërësi si të pa bazuara dhe ta vërtetoj aktvendimin e ankimuar.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, si dhe shikimin, analizimin dhe vlerësimin e komplet shkresave të lëndës, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195, 208 dhe 209 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

- Ankesa e paditësit, është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi E. S. nga fshati T., komuna Lipjan në gjykatën e shkallës së parë, ka ushtruar padi kundër të paditurës R. T. SH.P.K. njësia “RT PETROL” me seli në Çagllavicë, për shkak të kthimit në punë dhe kompensimin e të ardhurave personale.

Gjykata e shkallës së parë, pas analizimit dhe vlerësimit paraprak të padisë ka marrë aktvendimin e ankimuar C.nr. 63/2020 i datës 12.12.2022, përmes së cilit padinë e paditësit e ka hudhur si të pas afatshme, duke vendosur konkretisht si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar.

Gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e aktvendimit të ankimuar ka theksuar se: Pas shqyrtimit paraprak të padisë gjykata me shikimin në shkresat e lëndës, veçanërisht me shikimin në kërkesë me të cilën paditësi ja ka drejtuar të paditurës me rastin e shkëputjes së marrëdhënies së punës, e ka vërtetuar që kërkesa është parashtruar me datë 14.05.2020, dhe që paditësi është njoftuar për shkëputjen e marrëdhënies së punës me datë 14.04.2020. Paditësi ka parashtruar padi në këtë gjykatë më 01.06.2020, pas mbarimit të afatit të parashikuar me ligj prej tridhjetë (30) ditë nga dita kur është njoftuar për ndërprerjen e marrëdhënies së punës. Në përputhje me dispozitën e nenit 79 të Ligjit të punës Çdo i punësuar i cili nuk është i kënaqur me vendimin me të cilin mendon se i janë shkelur të drejtat e tij, ose nuk merr përgjigje brenda afatit nga neni 78 paragrafi 2. të këtij ligji, në afatin vijues prej tridhjetë (30), ditësh, mund të inicioj kontest pune në Gjykatën Kompetente.

Më tej ka theksuar se: Në dispozitën e nenit 389 të Ligjit për procedurën kontestimore është paraparë që pas shqyrtimit paraprak të padisë gjykata mund të marrë të gjitha aktvendimet të përmendura në nenin 392 të Ligjit të Procedurës kontestimore të këtij ligji, përveç kur kanë të bëjnë me gjëra për të cilat sipas natyrës së tyre ose sipas dispozitave të këtij ligji aktvendimi mund merret vetëm në procedurën e mëtutjeshme të procedurës kontestimore. Në dispozitën e nenit 391 të ligjit të procedurës kontestimore është paraparë që pas shqyrtimit paraprak të padisë gjykata me aktvendim do ta hedh padinë si të palejuar nëse e vërteton që: f) që padia është parashtruar pas kalimit të afatit, nëse me dispozita të veçanta është paraparë afati për parashtrimin e saj.

Pikëpamjet juridike të gjykatës së shkallës së parë, Gjykata e Apelit nuk mund t'i pranojë si të rregullta dhe të ligjshme, për arsye se aktgjykimi i atakuar është përfshirë me shkelje thelbësore nga neni 182.2, pika (n) lidhur me nenin 931 par. 1 pika f i LPK-së, meqë ka të meta që nuk mund të ekzaminohen, dispozitivi dhe arsyetimi i aktvendimit nuk janë në harmoninë e duhur logjike dhe juridike.

Gjykata e Apelit e ka vlerësuar mënyrën e vendosjen në këtë çështje juridike kontestimore nga ana e gjykatës së shkallës së parë dhe ka gjetur së pretendimet ankimore të palës paditëse për shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 391 par. 1 pika f) të LPK-së, janë të bazuara.

Kjo gjykatë vlerëson së aktvendimi i atakuar është përfshirë në shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 1, lidhur me neni 391 par. 1 pika f) të LPK-së, për shkak se në çështjen kontestuese nuk janë plotësuar kushtet ligjore për ta hudhur poshtë padinë si të pas afatshme. Gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se paditësi padinë e ka ushtruar pas afatit ligjorë të paraparë nga neni 79 të Ligjit të Punës, mirëpo gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë në menytë gabuar ka vendosur si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar pasi që nga shkresat e lëndës konstatohet se e paditura me datë 14.04.2020 e ka njoftuar paditësit për largim nga pune, kundër të cilit njoftim paditësi me datë 14.05.2020 ka ushtruar ankesë pranë të paditurës për largim nga pune dhe e paditura në të njëjtën ditë ju ka përgjigjur në ankesën e paditësit e që në rastin konkret afati për parashtrimin e padisë në gjykatë fillon të rrjedhë nga dita e marrjes së përgjigjes në ankesën e paditësit nga e paditura dhe kjo në kuptim të nenit 78 par.1 i Ligjit të Punës, i cili parasheh që “ *I punësuari i cili vlerëson se punëdhënësi ka shkelur të drejtën e marrëdhënies së punës, mund të paraqesë kërkesë te punëdhënësi apo organi përkatës i punëdhënësit nëse ekziston, për realizimin e të drejtave të shkelura*” ndërsa sipas paragrafit 2 të po të njëjtit ligj është paraparë që “ *Punëdhënësi është i obliguar për të vendosur sipas kërkesës së të punësuarit, në afatin brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data e pranimit të kërkesës*” dhe me qenë se e paditura me datë 14.05.2020 është përgjigjur në ankesën e paditësit dhe që nga kjo ditë paditësi brenda afatit prej 30 ditësh mund të ushtrojë padi në gjykatën kompetente. Sipas nenit 79 të Ligjit të Punës i cili parasheh që “ *Çdo i punësuar i cili nuk është i kënaqur me vendimin me të cilin mendon se i janë shkelur të drejtat e tij, ose nuk merr përgjigje brenda afatit nga neni 78 paragrafi 2. të këtij ligji, në afatin vijues prej tridhjetë (30) ditësh, mund të inicioj kontest pune në Gjykatën Kompetente*”. Andaj, në rastin konkrete nga dita e marrjes së përgjigjes në ankesën e paditësit nga e paditura nuk kanë kaluar 30 ditë, pasi që paditësi padinë e tij e ka parashtruar me datë 01.06.2020 dhe gjykata e shkallës së parë gabimisht është lidhur me datën e largimit nga puna, datë 14.04.2020, kjo për faktin se ligji i punës nuk parasheh asnjë afat për parashtrimin e ankesës ndaj vendimit të punëdhënësit për largim nga puna. Andaj, në rastin konkret nuk janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore nga neni 391 par 1 pika f) i LPK-së dhe gjykata e shkallës së parë është dashur që të caktoj seancën përgatitore apo edhe seancën e shartimit kryesorë dhe jo të vlerësoj padinë e paditësit në kuptim të kërkesës së anulimit të aktvendimit.

Nga arsyet e cekuar Gjykata e Apelit, gjeti së gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore të sipër theksuara, të cilat shkelje në rigjykim duhet të eliminohen në atë mënyrë që gjykata e shkallës së parë të kujdeset që të plotësohen të gjitha kushtet ligjore për mbajtjen e seancës përgatitore apo të shqyrtimit kryesorë, ti ftojë palët në mënyrë të rregullt, të administroj prova dhe varësisht nga rezultati i provave të vendosë për bazueshmërinë e kërkesë padisë së paditësit. Në çdo rast veprimet dhe vendimet e gjykatës duhet të jenë në përputhje me dispozitat e LPK-së.

Nga te cekurat me lartë, e ne mbështetje te dispozitave nga neni 194, 208 dhe 209 par. 1 pika (d) e LPK-së, u vendos si ne dispozitiv te këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË  
AC.nr.1763/2023 datë 04.04.2024

Kryetari i kolegjit - gjyqtari,  
Besnik Bislímaj, d.v